

2020

Përmbledhje Jo-Teknike “HELLAS SERVIS” shpk

MENAXHIMI I MBETJEVE
ZHVILLUESI: “HELLAS SERVIS”

HARTOI: “GR ALBANIA” SHPK



Projekti: "Menaxhimi i mbetjeve"

Shoqëria:

HELLAS SERVIS sh.p.k

Përgatitur
nga:



Korrik, 2020

Contents

1. HYRJE	0
2. KUSHTET EKZISTUESE	0
3. PËRSHKRIM I SHKURTER I AKTIVITETIT.....	1
4. TRANSFERIMI I MBETJEVE	3
5. MBETJET	4
6. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS DHE MASA	5

1. HYRJE

Shoqëria Hellas Servis sh.p.k synon zhvillimin e aplikimit për leje mjedisi të tipit B si rrjedhojë e rinovimit të lejeve ekzistuese që shoqëria disponon dhe me të cilat shoqëria ka operuar. Në vijim të komunikimeve zyrtare që shoqëria pati me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit I është komunikuar nëpërmjet shkresës me Nr. 640/9 Prot., datë 23.10.2019 mbi fillimin e procesit për pajisje me leje mjedisi të re mjedisi dhe për vlefshmërinë e procesit të VNM-së për lejet mjedisore ekzistuese që shoqëria disponon se:

Referuar Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” i ndryshuar dhe fakti që objekti ku kërkohet të zhvillohet aktiviteti është ekzistues dhe i pajisur me leje mjedisi me PN-2069-07-2011 për veprimtarinë “Transport dhe magazinim të baterive dhe vajrave lubrifikante të përdorura dhe filtra” dhe PN-3344-04-2012 për veprimtarinë “Grumbullim, transport dhe magazinim të pajisjeve elektrike dhe elektronike të përdorura” dhe bazuar në Ligjin Nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, shtojca 1, Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi, operatori “Hellas Servis” sh.p.k duhet të aplikojë pranë QKB-së:

- 1.1 Menaxhimi i mbetjeve I.D 5.7 Magazinim, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike – Kapaciteti kufi për lejet e Tipit B – Të gjitha instalimet dhe I.D 5.10.a Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart – Kapaciteti kufi për lejet e tipit B – Të gjitha instalimet, në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri.
- Referuar VKM nr. 419, datë 25.06.2014 të ndryshuar, 2.1 Pika ç) Lejet mjedisore ekzistuese PN-2069-07-2011 dhe PN-3344-04-2012 janë të barasvlershme me Vendim Paraprak të AKM-së apo të Deklaratës Mjedisore të ministrit.

2. KUSHTET EKZISTUESE

Shoqëria HELLAS SERVIS shpk është një shoqëri tregtare e krijuar si person juridik në bazë të vendimit të gjykatës nr. 20225, date 02.11.1998, kryesisht në:

- Shërbime profesionale teknike në fushën e ndërtimit dhe të mirëmbajtjes së rrjeteve të telefonisë celulare, shërbime teknike në pajisje gjeneratorë, elektrikë dhe elektronike etj.

Në kuadër të këtyre aktiviteteve Shoqëria HELLAS SERVIS SHPK kryen dhe aktivitete të tilla dytësore si: Grumbullim, depozitim, transportim të baterive të përdorura, vajrave lubrifikante, pajisjeve elektrike dhe elektronike. Ky aktivitet është kryer deri tani në bazë të dy Lejeve mjedisore dhe Licencës përshkruar më lartë.

Vendndodhja e mbetjeve të grumbulluara nga aktiviteti: grumbullimi i baterive të përdorura, vajrave dhe pajisjeve elektrike dhe elektronike kryhet në objektin magazinë të marrë me qira shoqërisë “ENERGIA B” sh.p.k. , i cili ndodhet në Autostradën Tiranë - Durrës, Km 6, Kashar, Tiranë, si pronarë e pasurisë. Nga kjo pronë Shoqëria HELLAS SERVIS SHPK për qëllime të aktivitetit të saj ka marrë me qira këto ambiente:

- Ndërtesa (zyra) 59m²

- Ambiente servise 150m²
- Ambiente magazine 183,75 m²
- Truall 594 m²
- Depozitë karburanti : 18m²



3. PËRSHKRIM I SHKURTER I AKTIVITETIT

Shoqëria HELLAS SERVIS SHPK ofron shërbime teknike në fushën e telekomunikacionit në lidhje me shërbimet teknike të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrjetit të telefonisë celulare në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Në kuadër të këtij aktiviteti dhe bazuar në detyrimet kontraktore me klientët lind e nevojshme ndërrimi i pajisjeve që ndodhen nëpër stacionet e klientit të tilla si, transportimi dhe grumbullimi i baterive të përdorura, të cilat hiqen nga stacioni si pasojë e daljes jashtë përdorimit apo dhe zëvendësimi i tyre me pajisje të tjera të reja sipas kërkesave të klientit.


Gjithashtu, gjatë kryerjes së servisit të gjeneratorëve nëpër stacionet e klientëve, lind nevoja e ndërrimit të vajrave dhe filtrave të këtyre pajisjeve duke krijuar në këtë mënyre mbetje të tilla si vajrat e përdorur. Përveç kësaj shoqëria kryen dhe servis të makinave për llogari të saj, aktivitet i cili gjeneron dhe ky vajra, të cilat grumbullohen pranë magazinave të shoqërisë dhe më pas transportohen tek ricikluesi, i cili mund të jetë kompani shqiptare e licensuar apo shoqëri e huaj ricikluese. Përveç, këtyre mbetjeve sipas rastit të aktivitetit dhe nevojave të klientëve është dhe aktiviteti i grumbullimit dhe transportimit të pajisjeve elektrike dhe elektronike të cilat mund të krijohen gjatë zhvillimit të këtyre aktiviteteve për llogari të klientëve si dhe për llogari të shoqërisë.



Transporti i këtyre mbetjeve, baterive, vajrave dhe pajisjeve elektrike dhe elektronike shoqëria i kryen më anë të mjeteve të përshtatshme të transportit, të cilat janë ose pronë e saj ose makina të marra në leasing nga të tretë. Për transportimin e vajrave përdoren automjete të përshtatshme të pajisur me Leje për transport dhe shofer të licencuar me licencë tipi ADR.

Vajrat që transporton shoqëria HELLAS SERVIS janë produkt ambalazhi metalik 20 litra, prodhim i shoqërisë "API". Vajrat janë të paketuara që në rafineri në mënyrë hermetike dhe nuk çlirojnë avuj. Këto lubrifikante janë të një cilësie të lartë dhe janë të pandezshëm. Gjithashtu edhe bateritë janë të një cilësie të lartë teknologjike hermetike dhe nuk çlirojnë avuj. Produktet e tjera si filtra etj. janë edhe këto të ambalazhuar në kuti kartoni dhe tregtohen në formën që vijnë nga importi të ambalazuara. Të gjitha produktet janë të vendosura në rafta metalike me hapësira të mjaftueshme për të garantuar lëvizjen e lire dhe të sigurt të punonjësve. Pjesa e magazinës së vajit, filtrave, baterive etj. është me ndarje të veçantë dhe komunikon me pjesët e tjera të objektit.

Magazina është e pajisur me sistem alarmi për zjarrin dhe me pajisjet përkatëse kundra zjarri si dhe me pajisjet e hidrantit. Në rast zjarri, automjetet zjarrfikëse mund të ofrohen dhe të veprojnë lirisht për shuarjen e tij pa pengese dhe në mënyrë efektive në çdo anë të objektit. Objekti është i kontrolluar edhe nga Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, sipas të cilit ky objekt i plotëson kushtet teknike dhe urbanistike për të kryer aktivitete të tilla dhe nuk rrezikohet nga objekte të rrezikshme rreth saj.



Shoqëria shfrytëzon ambientet e marra me qira vetëm për magazinimin dhe grumbullimin e baterive dhe vajrave të përdorur dhe pajisjeve elektrike dhe elektronike pa kryer asnjë proces tjetër manipulimi apo trajtimi të tyre. Shoqëria për zhvillimin e këtij aktiviteti kryen:

- transportin e baterive dhe vajrave të përdorur dhe pajisjeve elektrike dhe elektronike nga objekti i klientit ku këto tërhiqen si pasoje e shërbimit të mirëmbajtjes periodike që kryhen në kuadër të marrëdhënieve kontraktuale;
- Kryen magazinim të sigurt në mjediset e magazinës së shoqërisë në respektim të plote rregullave të sigurisë teknike në punë dhe mbrojtjen e shëndetit, për këtë kompani është certifikuar me ISO 18000;
- Ka nënshkruar aktualisht kontrata me kompani ricikluese për riciklimin e plote të mbetjeve.

Për vitin 2018, kompania nuk ka patur grumbullim mbetjesh të llojit bateri dhe pajisje elektrike dhe elektronike. Ndërsa në lidhje me riciklimin e vajrave të përdorur ka kontrate të rregullt bashkëpunimi me kompani të licensuar për riciklimin e vajrave të përdorur që është RADA OIL INDUSTRY SH.PK. me adresë në Durrës, Xhafzotaj, NIPT L21410501A.

4. TRANSFERIMI I MBETJEVE

Në lidhje me deklarinimin për Licencën III.2.B. sipas Kodit Unik ka kryer veprimtari transportimi sipas regjistrimit të transfertave.

Infrastruktura: Objekti ka infrastrukture të gatshme dhe ka komunikim të drejtpërdrejtë me rrugën dytësore të zonës që përshkon krahun e djathtë të autostradës Tiranë - Durrës. Kjo rrugë dytësore lidh të gjitha aktivitetet ekonomike që zhvillohen përgjatë kësaj rruge me zonën e banuar të Komunës Kashar, si dhe lidhet direkt me autostradën. Shoqëria nuk ka program ndërtimi pasi objekti është në fazë shfrytëzimi dhe i përshtatshëm për zhvillimin e aktiviteteve të saj.

Vendi i zgjedhur për zhvillimin e këtij aktiviteti ka këto përparësi:

- Ndodhet në një zonë të miratuar për aktivitete ekonomike jo-ndotëse;
- Është larg zonave të banuara dhe nuk ka afër shtëpi banimi;
- Zona nuk ka burime të ujërave nëntokësore dhe as praninë e ndonjë pellgu ujëmbajtës apo ujëmbledhës;
- Nuk ka probleme sociale e mjedisore;
- Ka infrastrukture të gatshme;
- Vendi është i lidhur me rrugë automobilistike;

Programi i monitorimit të ndikimit në mjedis është i hartuar sipas standardit ISO 14001. Çdo muaj maten dhe regjistrohen në një regjistër të veçantë mbetjet e krijuara, energjia e konsumuar etj. dhe sasitë e dërguara tek kompanitë ricikluese.

Referuar dy Lejeve të sipërcituara, janë kryer pranë Agjencisë Rajonale të Mjedisit Raportet e Vetë-monitorimit përkatësisht çdo gjashtë muaj dhe janë paguar rregullisht tarifat vjetore.

5. MBETJET

Të gjitha mbetjet magazinohen në magazinën e cila ndodhet brenda ambienteve të shoqërisë, organizuar sipas të gjitha standardeve. Më poshtë janë pasqyruar kodet e mbetjeve që gjenerohen nga aktivitetet I zhvilluar sipas Vendimit nr.99 datë 18.02.2005, "Për miratimin e Katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve":

Nga mbetjet me kodin 13 "Mbetje vajrash dhe mbetje të karburanteve të lëngshme (përveç vajrave ushqimorë dhe ato në kapitullin 05 12 19)" transporton, grumbullon dhe magazinon mbetjet si më poshtë:

- 13 01 Mbetje vajrash hidraulikë;
- 13 01 13 Vajra të tjerë hidraulikë (Vaj 10-30);
- 13 02 Mbetje vaji ingranazhesh, motori dhe lubrifikantë;
- 13 02 06 Vaj sintetik motori, ingranazhi dhe lubrifikues (Vaj 10-40);
- 13 02 07 Vajra lehtësisht të biodegradueshëm: motori ingranazh dhe lubrifikant (Vaj 20-50 dhe 15-40);

Nuk gjenerohen mbetje të kodit 13 03 "mbetje vajrash izolues dhe përcjellës nxehtësie" pasi ky shërbim që gjeneron këto vajra kryhet nga një shoqëri tjetër nënkontraktore (transformatorë). Nga mbetjet me kodin 16 "Mbetje të paspecifikuara në listë", transportohen, grumbullohen dhe magazinohen mbetjet si më poshtë:

16 01 Mbetje jashtë përdorimit nga mënyrat e ndryshme të transportit (duke përfshirë mjete jo rrugore dhe mbetje nga çmontimi i mbetjeve jashtë përdorimit dhe të mirëmbajtjes (përveç 13, 14, 16 06 dhe 16 08)

- 16 01 07* Filtra vaji, nafte (F542, LI9692, CAV296, RN58B)
- 16 01 99 Mbetje të tjera të paspecifikuara (filtër ajri FC1195 dhe FC735)

- 16 02 Mbetje nga pajisjet elektrike dhe elektronike"
- 16 02 14 Pajisje skarco të tjera nga ato të përmendura në 16 02 09 deri 16 02 13

- 16 06 Bateri dhe akumulatorë
- 16 06 05 Bateri dhe akumulatorë të tjerë

Shoqëria nuk kryhen menaxhim të integruar të mbetjeve, por vetëm transport, grumbullim dhe magazinim të tyre.

Grumbullimi, transporti dhe magazinimi i mbetjeve përkatëse bëhet sipas rregullave të përcaktuara në VKM përkatëse për secilin prej tyre ku për vajin e përdorur respektohen kriteret dhe procedurat e përcaktuara në VKM nr.765 datë 07.11.2012 "Për miratimin e rregullave për grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave të përdorura", për pjesët e aktivitetit që kryejnë në grumbullimin dhe ruajtjen e përkohshme sipas përkufizimeve në pikën 11 dhe 44 të nenit 3 dhe nenit 27 "Vajrat e përdorur" të Ligjit nr.10463 datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", për t'u dorëzuar më pas te shoqëritë e treta me të cilat janë lidhur kontrata për të kryer proceset e tjera të rikuperimit, riciklimit etj. sipas legjislacionit në fuqi.

Në vijim për bateritë, akumulatorët, pajisjet elektrike dhe elektronike respektohen të gjithë kërkesat e VKM nr.866 datë 04.12.2012 "Për bateritë, akumulatorët dhe mbetjet e tyre" dhe VKM nr. 957 datë 19.12.2012 "Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike.

Asgjësimi përfundimtar i mbetjeve, sic është shprehur dhe më lart, nuk realizohet nga shoqëria HELLAS SERVIS pasi shoqëria realizon vetëm grumbullim dhe magazinim të përkohshëm, por janë lidhur kontrata me shoqëri ricikluese të cilat marrin mbetjet nga magazinat e shoqërisë dhe dorëzohet dokumentacioni përkatës, ku çdo tërheqje shoqërohet me raportet e transferimit të mbetjeve.

6. IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS DHE MASA

Përshkrimi i shkurtër i zonës

Objekti është i vendosur në zonën periferike të Tiranës, përgjatë autostradës Tiranë-Durrës. Kjo zonë është një zonë me aktivitetet industrial ku në të dyja anët e autostradës ka objekte të shumta që ushtrojnë aktivitetin e tyre tregtar ose prodhues. Zona ndodhet në perëndim të qytetit të Tiranës, në Kashar, Kilometri i 6 i autostradës Tiranë-Durrës. Për shkak të zhvillimit të aktivitetit industrial në këtë zonë sikurse dhe nga vetë natyra e aktivitetit të subjektit, zhvillimi i tij nga HELLAS SERVIS nuk konsiderohet si aktivitet me ndikime në zonën përreth.

Ndotja e ajrit

Gjatë zhvillimit të aktivitetit pritet prezenca e erës karakteristike të hidrokarbureve në magazinë por që nuk përhapet jashtë ambientit rrethues të subjektit. Aktiviteti i subjektit është transporti dhe magazinimi i mbetjeve dhe jo përpunimi i tyre dhe për këtë arsye nuk pritet prezenca e shkarkimit të ndotësve në ajër. Ndotja e mundshme në ajër konsiderohet e papërfillshme, tepër minimale dhe e kufizuar në kohë pasi sistemi i instalimit dhe teknologjia e përzgjedhur minimizon në maksimum emetimin e aromave dhe rrjedhjet e gazeve në atmosferë.

Ndotja e ujit

Në përgjithësi nga vetë natyra e aktivitetit të subjektit nuk parashikohen shkarkime ujore apo ndotje pasi aktiviteti është i kufizuar vetëm në transportin dhe magazinimin e mbetjeve dhe asnjë trajtim i tyre nuk ndodh në objekt. Në rast derdhesh aksidentale të hidrokarbureve në sipërfaqe përsëri nuk parashikohet ndotje pasi sipërfaqja është e shtruar me beton dhe si rrjedhojë është i pamundur infiltrimi i hidrokarbureve në ujërat nëntokësore. Ndotja e ujit konsiderohet e papërfillshme.

Ndotja e tokës

Ujërat e ndotura nga tualetet dhe larja e ambienteve të ushtrimit të aktivitetit shkarkohet në sistemin e kanalizimit të ujërave të ndotura. Njësoj edhe për ujërat e shiut. Mbetjet e gjeneruara gjatë ditës së punës grumbullohen në koshat përkatës nga punonjësit e magazinës dhe më pas largohen për vendndodhjen e grumbullimit të mbetjeve nga Bashkia. Nuk parashikohen ndikime negative në tokë nga ushtrimi i aktivitetit.

Rastet aksidentale

Zbatimi i aktivitetit të subjektit vlerësohet se nuk do të sjell rrezikshmëri për aksidente. Në rast zjarri automjetet zjarrfikëse mund të afrohen dhe të veprojnë për shuarjen e tij pa pengesë dhe në mënyrë efektive. Objekti plotëson të gjitha kërkesat teknike dhe urbanistike për të kryer një aktivitet të tillë. Gjithashtu mbajtja e fikësve të zjarrit në objekt është e nevojshme, në rastet e ndërhyrjes ndaj zjarrit. Janë marr masat për parandalimin e rasteve aksidentale, mjetet kontrollohen vazhdimisht për gjendjen teknike të tyre në mënyrë që të mos kemi rrjedhje lubrifikanti apo karburant. Shoqëria siguron se do ketë ndërhyrje të menjëhershme nëse do të ketë ndikim negative në mjedis.

Flora dhe fauna

Nuk parashikohen ndikime në bimësi duke përmendur lloje endemike, lloje me status të veçantë, habitate me vlera, ekosisteme funksionale etj. Zona nuk ka vlera të veçanta floristike megjithatë zona e subjektit për ushtrimin e aktivitetit është e kufizuar në një sipërfaqe jo të madhe. Gjithashtu edhe për faunën e zonës, lidhur me specie me status të veçantë dhe të mbrojtura, theksohet se specie të tilla nuk janë prezentë në zonën e aktivitetit. Përreth zonës mund të hasen vetëm shpend të qytetit.

Monumente, trashëgimi, vepra

Nuk ka vlerë trashëgimore zona e ushtrimit të aktivitetit. Lidhur me peisazhin, inxhinieret janë kujdesur gjatë fazës së projektimit për anën estetike të projektit dhe hapësira të gjelbëruara.